



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga: “Abdi Toptani”, ish-hotel “Drini”, Tiranë

Tel. 04268141; Fax 04 268142

Nr. 254 Prot.

Tiranë, më 04.04.2017

V E N D I M

Nr.70, datë 04/04/2017

“Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në konkurrimet e planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2017, me procedurat e pranimit në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND)”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 2, datë 13.01.2017, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2017”, ka miratuar planifikimin vjetor të procesit të mbikëqyrjes, duke përcaktuar llojin dhe objektin e mbikëqyrjeve dhe subjektet që do të kontrollohen gjatë këtij viti.

Në këtë planifikim, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që kanë procedurat e rekrutimit në lidhje me: **a)** pranimin në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil; **b)** lëvizjen paralele; **c)** ngritjen në detyrë dhe **ç)** pranimin në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), në institucionet e administratës shtetërore, për të siguruar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional dhe të bazuar në meritë, ç’ka përbën edhe qëllimin e ligjit për nëpunësin civil, është parashikuar zhvillimi i “mbikëqyrjes së orientuar”, përcaktuar në nenin 14/1, germa “c”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, me qëllim mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurremeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2017.

Për këtë arsye,

në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 02, datë 13.01.2017, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin

2017”, të Komisionerit, me qëllim që të mbikëqyr zbatimin e ligjit në administrimin e procedurave të konkurremeve të planifikuara për t’u zhvilluar, nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2017,

VENDOSA:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar, me objekt mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurremeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2017.
2. Ngritjen e grupit të mbikëqyrjes, me këtë përbërje:

1. Altin SHUMELI	Drejtor i Mbikëqyrjes
2. Saimir MUÇMATAJ	Inspektor (Përgjegjës grupi)
3. Ina SKËNDERI	Specialist IT (Anëtar)

2. Anëtarët e grupit të mbikëqyrjes, së bashku ose veç e veç, kanë të drejtë të paraqiten dhe të kërkojnë çdo dokumentacion të nevojshëm, në të gjitha institucionet që nxjerrin akte administrative, apo kryejnë procedura të caktuara, që kanë lidhje me procesin e rekrutimit, të tilla si testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.
3. Me këtë vendim të njihet grupi i mbikëqyrjes dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit për të zbatuar këtë vendim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA